



Departamenti i Prokurimit

Prishtine datë, 04.06.2018

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Prishtinës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës **01.06.2018**, të parashtruar nga Operatori Ekonomik **Pastor Kosova SHPK** lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **"Blerja e pajisjeve hidraulike për AKRR, gypa-zorre dhe ekstrakt – shkume për BPZ"**, me Nr. të Prok: **616 18 009 121** nxjerr:

V E N D I M

1. Aprovohet pjesërisht kërkesa për ri-shqyrtim e Operatori Ekonomik Pastor ShPK të dt. 01.06.2018 lidhur me aktivitetin e prokurimit " **Blerja e pajisjeve hidraulike për AKRR, gypa-zorre dhe ekstrakt – shkume për BPZ**" me Nr. **616 18 009 121** kundër Njoftimit për dhënie të Kontratës të AK –së, të datës 28.05.2018 të publikuar në web-faqe të KRPP-së .
2. **Anulohet vendimi i AK për dhënien e kontratës të publikuar me datë: 28.05.2018;**
3. Autoriteti Kontraktues, vendos që të anulohet Njoftimi për dhënie të kontratës dhe e mungesë të ofertave të përgjegjshme të anulohet **aktivitetin e prokurimit.**
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

Arsyetim

Operatori Ekonomik **PASTOR ShPK** me datë 01.06.2018, ka parashtruar kërkesën për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **Blerja e pajisjeve hidraulike për AKRR, gypa-zorre dhe ekstrakt – shkume për BPZ** me Nr. **616 18 009 121**.

Autoriteti Kontraktues, me datë 01.06.2018, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

1. OE pretendon se janë shkele:

Neni 7 Barazia ne trajtim/Jo diskriminim; **Neni 56** Dispozitat e pergjithshme mbi Perzgjidhjen e pjesemarresve dhe Dhenien e kontrates; **Neni 59** Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve OE Pastor Kosova - ka pasur ofertë të përgjegjshme me cmimin më të lire; **Neni 60** – Kriteri per Dhenien e Kontrates/Tenderi i pergjegjshem me cmimin me te ulte

Ne lidhje me dispozitat e shkelura te LPP-se për te cilat pretendon "PASTOR" ShPK, Autoriteti Kontraktues sqaron se ka bërë vlerësimin e ofertave ne përputhje te plote me Ligjit për Prokurimin Publik Nr. 04/L-042, dhe njëkohësisht ka respektuar vendimin e OSHP-se nr.1135/2017 te datës 03.04.2018.

AK ju bene me dije se Autoriteti Kontraktues është i obliguar qe te respektojte vendimet e OSHP-se dhe kundër vendimit te OSHP-se pala mund ti drejtohet Gjykatës themelore.

2. OE pretendon se OE i shperblyer me kontarte nuk nuk eshte i pergjegjshem.

Ne Aneksi 1. Specifikimet Teknike te Detyrueshme te DT – Pozicioni 1. Specifikacioni teknik gyp për zjarrfikëje Ø 52 , L= 15 m , Kualiteti SYNTEX 500 Ne DT eshte kerkuar Presioni testues : 25 bar OE i propozuar per dhenie te kontrates Albkos ka ofruar produktin me Presion testues/Test Pressure: 24 bar

AK pajtohet me pretendimin e OE dhe vendos qe te anuloj Njoftimin per dhenie te kontartes dhe e mungese te ofertave te pergjegjshme te Anuloj aktivitetin e Prokurimit.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lart ka vendosur si ne dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. Ankesa prane OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit te ketij vendimi.

Zyrtari përgjegjës i Prokurimit